

Sistemi për pengimin e korrupsionit në furnizimet publike akoma është jofunksional, ka mungesë të bashkëpunimit të ndërsjellë institucional, si dhe numër shumë të ulët të ankesave të dorëzuara nga ana e firmave. Sistemi i vjetër dhe aq i kritikuar për furnizime publike akoma është në fuqi, madje edhe një vit e gjysmë pas ndërrimit të pushtetit

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 17 dhjetor - Sistemi akoma jofunksional për pengimin e korrupsionit në furnizimet publike, mungesa e bashkëpunimit të ndërsjellë institucional dhe numri shumë i ulët i ankesave të dorëzuara nga ana e firmave për parregullsitë përgjatë tenderave prej vetëm 3 për qind... janë disa nga veçoritë e sistemit të furnizimeve publike në vitin 2017 dhe 2018, që shumë ngadalë po reformohet, vlerësojnë nga Qendra për Komunikime Qytetare.

"Një ligj i vetëm nuk mund të zgjidh problemin e korrupsionit, por i njëjti mundet vetëm të ngushtojë rrethin për këtë dukuri negative shoqërore. Fatkeqësisht, tek ne sistemi i institucioneve të lidhura që e kanë për detyrë të luftojnë në mënyrë efikase korrupsionin, nuk funksionon si duhet. Në praktikë kemi Polici Financiare, Komision për mbrojtjen e konkurrencës, revizorë të brendshëm, sistem i punëtorëve që denoncojnë aktet e korrupsionit brenda institucionit ku punon, megjithatë në zinxhirin e luftës kundër korrupsionit, nuk funksionojnë pjesët e tij përbërëse", thotë German Fillkov, kryetari i Qendrës për Komunikime Qytetare.

Sipas tij, në Ligjin e ri për furnizime publike janë pranuar një pje-

LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT NË FURNIZIMET PUBLIKE

SISTEM JOFUNKSIONAL



së e madhe e vërejtjeve dhe sugjerimeve të organizatave joqeveritare lidhur me harxhimin e drejtë dhe transparent të të hollave publike, megjithatë siç thotë ai, koha do të tregojë se sa ndryshimet ligjore kundër korrupsionit do të zbatohen në praktikë dhe nuk do të mbeten vetëm në letër.

Ai shton se sistemi i vjetër dhe aq i kritikuar për furnizime publike akoma është në fuqi, madje edhe një vit e gjysmë pas ndërrimit të pushtetit. Me një tempo kaq ngadalshme të reformimit në nivel sistemor kanë mbetur problemet e vjetra, ndërsa në nivel institucional - shumë organe kontraktuese kanë vazhduar me praktikën e vjetra të këqija.

Ligji i ri për furnizimet publike pritet të hyjë në fuqi prej pranverës së vitit 2019, që në fokus do të ketë shpagueshmërinë e asaj që blihet. Vendoset edhe kontrolli edhe masat antikorrupsion. "Megjithatë, kryesorja për zbatimin e tërësishëm të ligjit do të jetë përgatitja e mirë e personave që do të realizojnë furnizimet publike, si dhe përgatitja e akteve nënligjore", thonë nga Qendra për Komunikime Qytetare.

Në ndërkohë, analizat e kësaj organizate tregojnë se aktualisht, Prokuroria Speciale si duket luan

rolin kryesor në luftën kundër korrupsionit në furnizimet publike. Nga 24 lëndë nga kjo prokurori, gjashtë janë për keqpërdorime në furnizimet publike, prej të cilave për tre udhëhiqen procedura gjyqësore, ndërsa për tre të tjera janë sjellë vendime gjyqësore. Për momentin udhëhiqen edhe gjashtë hetime të reja për dyshime të lidhura me keqpërdorimet në pozitës zyrtare gjatë furnizimeve publike.

Njëherazi, në vitin 2018, Prokuroria Publike ka hapur 39 raste, ku janë përfshirë 113 persona për kryerjen e veprës penale gjatë kryerjes së furnizimeve publike. Për dy lëndë janë parashtruar akte të akuzës, ndërsa për gjashtë lëndë është sjellë urdhër për realizimin e procedurës hetimore, ndërsa 31 lëndë janë në procedurë para hetimore.

"Edhe në grupin e institucioneve që duhet të luajnë rolin kryesor në parandalimin e korrupsionit në furnizimet publike është Komisioni Anti Korrupsion. Nëse lëmë anash faktin se ky trup nuk funksionon gati tërë vitit 2018, edhe në të kaluarën ai nuk e ka luajtur rolin e tij në mënyrë të kënaqshme. Në vitin 2017 dhe 2018, ky komision nuk ka dërguar asnjë rast deri tek Prokuroria për ngritjen e mëtejshme të pro-

cedurave", theksohet në analizën e Qendrës për Komunikime Qytetare.

Më tej, në analizë, thuhet se hallkë tjetër e zinxhirit në luftën kundër korrupsionit që nuk funksionon është sistemi i Kontrollit të brendshëm financiar në institucione përfshi edhe revizorët e brendshëm. Enti Shtetëror për Revizion në mënyrë të rregullt i thekson parregullsitë gjatë realizimit të tenderëve, si rezultat i revizioneve të realizuara në institucionet shtetërore. Në vitin 2018, ky institucion ka dorëzuar tek Prokuroria 12 raporte, prej të cilëve, dy janë për shkak të vlerësimit se është kryer veprë penale e shkeljes së Ligjit në furnizimet publike. Për dy lëndë janë parashtruar akuza, për gjashtë lëndë është sjellë vendim për ngritjen e procedurës hetimore, ndërsa 31 lëndë gjenden në procedurë para hetimore.

Gjithashtu, pjesë e luftës kundër korrupsionit në furnizimet publike, por pa ndonjë rol me të rëndësishëm në vitet e fundit, është edhe Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, Policia Financiare dhe Avokati i Popullit.

Ndryshe vlera e tenderave vitet e kaluara shënon ulje në Maqedoni, nga 962 milionë euro në vitin 2016, në 625 milionë euro në vitin 2017.

Trajnim për avokatët që punojnë me fëmijët viktime

Shkup, 17 dhjetor - Avokatët të cilët punojnë me fëmijë në kontakt me ligjin duhet të paktën pesë ditë gjatë vitit të vijojnë trajnime të specializuara për drejtësi për fëmijët, në të cilat do t'i pasurojnë njohuritë e tyre në mbrojtjen e fëmijëve të cilët kanë kryer apo dyshohen për veprë penale, fëmijët dëshmitarë dhe fëmijët viktime. Këtë e parashikon Memorandumi për bashkëpunim që dje në Qeveri e ka nënshkruar ministria e Drejtësisë Renata Deskovska, përfaqësuesi i UNICEF-it Benxhamin Perks, kryetari i Odës së Avokatëve Lubomir Mihajllovski dhe kryetari i organizatës joqeveritare Aleanca për parandalimin e delikucencës dhe delikucencës së të miturve gjykatësi Lazar Nanev. Bashkëpunimi, siç theksuan nënshkruarit e Memorandumit, do të kontribuojë të përforcohet lidhja mes të gjitha institucioneve, mbledhjen dhe shfrytëzimin e të dhënave për fëmijët në kontakt me ligjin. Sipas statistika-ve, siç theksoi ministria Deskovska, çdo vit në Maqedoni rreth 1.000 fëmijë vijnë në kontakt me sistemin gjyqësor, gjegjësisht këto janë fëmijë që kanë kryer ose janë të dyshuar për krime, fëmijë dëshmitarë dhe fëmijë viktime. Këto trajnime të specializuara për avokatët, siç ka shtuar ajo, do të japin kontribut shtesë në forcimin e institucioneve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Pas trajnimeve, Ministria e Drejtësisë, së bashku me Odën e Avokatëve do të përpilojnë listë të avokatëve të specializuar dhe do ta dorëzojnë në Qendrat për punë sociale, policisë, prokurorisë publike dhe gjyqësorit. (D.K)

Identifikohet viktime e tretë e aksidentit në Leskovc

Beograd, 17 dhjetor - Është identifikuar edhe viktime e tretë e aksidentit të autobusit që dy ditë më parë ndodhi në Leskovc të Serbisë. Ajo është 63 vjeçarja V.K nga Kavadar. Paraprakisht ishte konfirmuar identiteti i viktimeve tjera, gruaja 68 vjeçare nga Koçani me iniciale K.K dhe burri 68 vjeçar nga fshati Buçin i Krushevës me iniciale V.Sh. Në Serbi ende po hetohet për aksidentin e trafikut, ndërsa shoferi i autobusit me tabela të Strugës, është në paraburgim. Në aksident janë lënduar 32 persona. Gjashtë personat e lënduar rëndë pas aksidentit të komunikacionit në Le-

skovc gjenden në Qendrën klinike në Nish, ndërsa tetë të lënduarit lehtë gjenden për mjekim në spitalin e Leskovcit. Mbrëmë vonë, ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe me sekretarin e përgjithshëm të Qeverisë, Dragi Rshkovski i vizituan udhëtarët e lënduar në spitalet në Leskovc dhe Nish. Dymbëdhjetë personat tjerë me lëndime të lehta dhe dy fëmijët të cilët ishin të vendosur në hotelin "Apostoliq" në Leskovc, mbrëmë në mënyrë të organizuar u kthyen në Maqedoni. Udhëtarët të cilët udhëtonin nga më shumë qytete të Maqedonisë për Vjenë me tran-

sportuesin "Euro bus" nga Velesh-ta e Strugës, ishin kryesisht mërgimtarë nga Maqedonia, ndërsa në momentin e fatkeqësisë, të gjithë flinin. Sipas dëshmitarëve, deri te aksidenti kishte ardhur për shkak të kushteve të këqija, akullit dhe shpejtësisë së madhe të shoferit të autobusit nga gati 100 kilometra në orë dhe mundësisë që shoferi të kishte fjetur. Shoferi i autobusit e kishte humbur kontrollin, kishte dalë nga autostrada, pas çka ishte përmbysur disa herë. Falë intervenimit me kohë për vetëm gjysmë ore nga aksidenti të tetë automjeteve të ndihmës së shpejtë



nga Nishi dhe Leskovci, të zjarrfikësve dhe kalimtarëve të rastit, të cilët i nxorën udhëtarët nga autobusi, është parandaluar ndonjë tragjedi më e madhe. Ndhimë e

madhe dhe e pakusht është ofruar edhe nga kryetarët e Nishit dhe Leskovcit nga institucionet e mjekësisë së këtyre qyteteve për shpëtimin e të lënduarve.